
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Tiranë, më 31.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIMI DHE INSTALIMI I PAJISJEVE TË
MBROJTJES KUNDËR ZJARRIT PËR NEVOJAT E AUTORITETIT KONTRAKTOR
AQSHF”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Sisteme për zbulimin e zjarrit 31625100-4

Sinjalistikë 34928470-3

Materiale sinjalistike 34928471-0

Fikëse zjarri 44482100-3

Hidrantë zjarri 44482200-4

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS: 1,249,833 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues,

duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.”

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që përvojat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose

organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme)

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të percaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku percaktohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur.

ISO 9001 ose ekuivalent përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike / broshurë për të gjithë artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike për secilin artikull, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të mallrave sipas dokumenteve të tenderit. Nëse katalogu/ët / skeda teknike janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedës teknike të prodhuesit ka disa avantazhe: Besueshmëria e informacionit: Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike: Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Parandalimi i mashtrimeve: Redukton rrezikun e mashtrimeve ose të ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog/skede teknike do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

4. Operatori ekonomik duhet të lëshojë një deklaratë për periudhën minimale 24 muaj të garancisë së mallrave objekt prokurimi, nga data e dorëzimit të mallit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor përfitues që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga autoriteti kontraktor përfitues Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, nga pikëpamja teknike, ekonomike dhe funksionale, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar si dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Bazuar në kërkesat teknike të institucionit, materialet duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme në përputhje me të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit:

	Pajisja	Specifikimi Teknik
1	Detektorë Tymi (50 copë)	Dedektor tymi me bateri, garancia 5 vjet, konform standarteve SSH EN 54-7 ose ekuivalente.
2	Hidrantë Muri (2 copë)	Kuti metalike e kompletuar, tub fleksibël min 20m- max 30m, kokë hedhese me 3 pozicione.
3	Fikëse CO2 (5kg) (20 copë)	Për depo filmi. Agjent fikës që nuk lë mbetje dhe nuk dëmton emulsionin. Sipas SSH EN 3-7 ose ekuivalente: ngjyra RAL 3000 ose ekuivalente.
4	Fikëse ABC(6kg) (15 copë)	Për ambiente administrative dhe korridore, sipas standartit SSH EN 3-7 ose ekuivalent, ngjyra ral 3000 ose ekuivalent.
5	Sinjalistika (60 copë)	Sinjalistike për dalje emergjente në rast zjarri në përputhshmeri me SSH ISO 7010 ose ekuivalente

Tabela 1: Specifikimet për Detektorët e Tymit

Karakteristika	Kërkesa Teknike
Tipi	Detektor tymi me bateri
Certifikimi	Konform standartit SSH EN 54-7 ose ekuivalent
Treguesit	Dritë LED (360° e dukshme) për gjendjen e alarmit dhe gatishmërinë.
Funksioni	Buton testimi për ristartimin e sensorit.
Sasia	50 copë

Tabela 2: Specifikimet për Hidrantët e Zjarrit (Muri)

Karakteristika	Kërkesa Teknike
Tipi	Kuti hidranti e brendshme (Muri), e kompletuar.
Standardi	Konform standardit SSH EN 671-1 ose ekuivalent
Tubacioni	Kuti metalike e kompletuar, tub fleksibël min 20m- max 30m.
Koka (Nozzle)	Me tre pozicione: Mbyllur / Currila (Jet) / Mjegull (Spray).
Kutia	Metalike me veshje elektrostatiqe, derë me xham të thyeshëm dhe çelës sigurie.
Sasia	2 copë

Tabela 3: Specifikimet për Fikëset e Zjarrit me CO2 (Për Vendruajtjet e Filmit)

Karakteristika	Kërkesa Teknike
Agjenti Fykës	Dioksid Karboni (CO2) – Nuk lë mbetje dhe nuk dëmton emulsionin filmik.
Kapaciteti	5 kg (për operim manual të lehtë).
Certifikimi	Konform standardit sipas SSH EN 3-7 ose ekuivalent
Materiali i cilindrit	Çelik me cilësi të lartë, i testuar për presion të lartë.
Aksesoret	Tub fleksibël dhe hinkë shpërndarëse dielektrike (për siguri elektrike).
Sasia	20 copë

Tabela 4: Specifikimet për Fikëset e Zjarrit me Pluhur (ABC)

Karakteristika	Kërkesa Teknike
Agjenti Fikës	Pluhur kimik i thatë (Dry Powder) - ABC 40%
Kapaciteti	6 kg (Pesha standarde për efikasitet dhe përdorim praktik).
Certifikimi	Konform sipas standardit SSH EN 3-7 ose ekuivalent
Klasat e Zjarrit	A (Materiale të forta), B (Lëngje të ndezshme), C (Gazra).
Presioni i punës	15 bar -18 bar në +60°C -30°C (me manometër kontrolli të integruar).
Materiali i cilindrit	Çelik me mbrojtje kundër korrozionit bojë polyester / RAL 3000 ose ekuivalent
Aksesoret	Tub fleksibël me kokë shpërndarëse dhe krah fiksues për mur.
Temperatura e përdorimit	Nga -30°C deri në +60°C.
Sasia	15 copë

Tabela 5: Specifikimet për Tabelat Sinjalistike të Emergjencës (EXIT)

Karakteristika	Kërkesa Teknike
Piktogrami	Simboli standard i "Njeriut që vrapon" me shigjetë orientuese (poshtë, majtas, djathtas) sipas imazhit.
Materiali	Alumin i qëndrueshëm ose PVC e cilësisë së lartë, rezistente ndaj zjarrit.
Lloji i Ndriçimit	Fotolumineshent (vetë-ndriçues në errësirë) ose LED me bateri rezervë (për vizualitet maksimal).
Standardi	Me përputhshmëri me SSH ISO 7010 ose ekuivalent
Teksti	Mbishkrim i qartë "DALJE EMERGJENCE"
Montimi	Të parashikohet me bazë fiksuese për mur ose tavan, varësisht nga pika e instalimit në Arkiv.
Sasia	60 copë

PËRSHKRIMI I FURNIZIMIT

Furnizimi përfshin transportin e pajisjeve në ambientet e Arkivit, montimin e detektorëve në tavane, montimin dhe fiksimin e kutive të hidrantëve në mure dhe vendosjen e fikëseve të zjarrit në mbajtëset përkatëse sipas planit të evakuimit.

STANDARDET DHE UDHËZIMET TEKNIKE

- Të gjitha produktet duhet të kenë markimin CE.
- Instalimi duhet të kryhet sipas rregullores teknike për mbrojtjen nga zjarri në ndërtesa.
- Pajisjet duhet të kenë etiketa në gjuhën shqipe me udhëzimet e përdorimit.

AFATET DHE PLANI I DORËZIMIT

- **Afati i furnizimit:** Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.
- **Testimi:** Pas montimit, do të kryhet testimi i plotë i presionit të hidrantëve.

DOKUMENTACIONI I DORËZIMIT

1. Libreza e mirëmbajtjes për fikëset e zjarrit.
2. Protokolli i testimit të vënies në punë.
3. Manuali i përdorimit dhe trajnimit të stafit.
4. Garanci teknike për pajisjet jo më pak se 24 muaj.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

NJËSIA E PROKURIMIT